

Fjala e ministrit të mbrojtjes Vllado Misajlovski me rastin e Ditës së Komandës për Operacione

Kazerman „Boro Menkov“ – Kumanovë, 17.10.2025

I nderuar shef i Shtabit të Përgjithshëm,

I nderuari komandant i Komandës për Operacione,

Tw nderuar gjeneralë, oficerë, nënoficerë dhe ushtarë,

Me kënaqësi të madhe ju drejtohem juve, pjesëtarëve të Komandës për Operacione, në ditën tuaj, e cila na kujton traditat në Armantën e Maqedonisë, por edhe është një ditë kur e konfirmojmë kontributin tuaj të përbashkët ndaj sigurisë së atdheut, sigurisë së qytetarëve dhe sigurisë kolektive të Aleancës sonë të përbashkët.

Në forcën goditëse të Armatës funksionojnë të gjitha llojet dhe shërbimet, pjesëtarët e të cilëve çdo ditë tregojnë profesionalizëm, motivim dhe përkushtim. Pikërisht nga radhët tuaja vijnë edhe pjesa më e madhe e pjesëtarëve që, së bashku me aleatët, e kanë forcuar krahun lindor të NATO-s në Letoni, Bullgari dhe Rumani. Por, të mos harrojmë – përkundrazi, ta theksojmë – se mbështetja më e madhe për qytetarët e Maqedonisë, kur përballemi me zjarre dhe lloje të tjera të fatkeqësive natyrore, gjithashtu vjen, në pjesën më të madhe, nga pjesëtarët e kësaj komande.

Kjo është një përgjegjësi e madhe, të cilën ju e përmbushni plotësisht, duke e justifikuar besimin tonë të plotë. Ju ekzistoni për atdheun dhe për bashkëqytetarët tanë, ndërsa ne, Ministria dhe Shtabi i Përgjithshëm, ekzistojmë për t'ju siguruar kushtet më të mira dhe pajisjet më moderne.

Buxheti mbrojtës i Maqedonisë do të vazhdojë të rritet, dhe një pjesë e konsiderueshme e këtyre mjeteve është e dedikuar pikërisht për modernizim dhe pajisje. Ju e meritoni këtë, ndërsa ne do të punojmë intensivisht që, përveç blerjes së pajisjeve, në vazhdimësi të përmirësojmë edhe pajisjet personale dhe armatimin. Në mënyrë plotësuese, së bashku me aleatët dhe partnerët tanë, po mundësojmë përmirësim të vazhdueshëm dhe zhvillim të aftësive dhe njohurive tuaja profesionale. Me përkushtimin tuaj, ju na obligoni për këtë!

Mesazhi im edhe për komandantin dhe eprorët në Komandë është: Vazhdoni të punoni me plot energji dhe përkushtim të plotë. Nga puna juaj varet siguria e secilit prej nesh. Jam i bindur në cilësitë tuaja, të cilat së bashku do të vazhdojmë t'i zhvillojmë çdo ditë e më shumë, dhe nuk kam asnjë dyshim se në vlerësimin e ardhshëm të NATO-s vitin që vjen, Armata e Maqedonisë do të paraqitet në dritën më të mirë.

Gjatë vitit të kaluar, Ministria e Mbrojtjes, së bashku me Shtabin e Përgjithshëm, ka pasur buxhetin më të madh historik që është miratuar ndonjëherë nga ndonjë Qeveri. Dje pata mundësinë t'i mbroj pozicionet në Bruksel, si për Ushtrinë e Maqedonisë, ashtu edhe për shtetin maqedonas. Viojmë vitin e ardhshëm dhe në vitet në vijim me një ritëm edhe më të fuqishëm, për të siguruar më shumë mjete dhe për të realizuar shumë projekte për modernizim për të gjithë ju.

Ajo që më gëzon veçanërisht është se shumë probleme dhe sfida që i kemi pasur në të kaluarën, e që ende i kemi që kur kam ardhur si ministër, i tejkalojmë me një moto të bukur që juve ju frymëzon – e ajo është se së bashku jemi më të fortë. Dua personalisht të shpreh falënderimin tim nga kjo foltore drejtpërdrejt për të gjithë ju, por veçanërisht për shefin e Shtabit të Përgjithshëm, zëvendësin, drejtorin, gjeneralin Gjorgjovski, të gjithë gjeneralët, por edhe për të gjithë të punësuarit në ministri – për të gjitha sfidat e përbashkëta që i zgjidhim së bashku.

Një fjali shumë e bukur që e dëgjova është ajo për sinergjinë, e cila na frymëzon të gjithëve që bashkë t'i përfundojmë të gjitha këto procese. Dhe vërtet jam mirënjohës, sepse me atë frymë mbështetjeje dhe me përkrahjen e plotë që e kam nga të gjithë gjeneralët, dua që të gjithë ta dini se edhe ju e keni përkrahjen time të plotë. Së bashku do të realizojmë shumë projekte.

Në prapavijë po punojmë në disa iniciativa, po punojmë në gjëra që me të vërtetë mund të jenë historike për të gjithë ju.

Po punojmë në zgjidhje dhe plane të reja se si të sigurojmë mjete shtesë dhe të blejmë pajisje të reja dhe moderne, dhe po punojmë në prapavijë për të siguruar shumë fonde granti direkt për ju në Armatë. Mendoj se së bashku do të krijojmë shumë, shumë momente të bukura historike në periudhën që vjen..

Nga këtu dua të falënderoj drejtpërdrejt gjeneralin Gjorgjoski për punën e shkëlqyer që bën, veçanërisht me marrjen në dorë të Komandës për Operacione, por edhe të gjithë të tjerët. Vazhdoni të punoni me përkushtim dhe me mund, të doni Maqedoninë dhe të ruajmë atdheun tonë.

Urime 17 tetori – Dita e Komandës për Operacione!

Rroftë Armata e Maqedonisë!

Rroftë Maqedonia!

Ju faleminderit të gjithëve.